

Në bazë të nenit 8, nenit 10 pika 2.3 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe nenit 15 të Rregullores për Marrëdhënien e Punës nr. 01-2978/22, të dt. 27.06.2022, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 01-2978/22, të dt. 28.03.2023, Telekom i Kosovës SH.A. shpall:


KONKURS PUBLIK Për Punë dhe Detyra Specifike

Titulli i punës: Teknik për Transmetimin e Ndeshjeve të FIFA World Cup 2026
Mandati: 2 - mujor
Ekzekutues: 1
Vendi: Prishtinë
Ndërmarrja: Telekom i Kosovës SH.A
Grada: C-10
Afati i fundit për aplikim: 12.05.2026

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Pranimi dhe menaxhimi i sinjalit hyrës (live feed) nga burimi i transmetimit, përfshirë integrimin e sinjalit zanor nga kabina e komentimit, si dhe përgatitja teknike e pikës së komentimit dhe optimizimi i audios për mbarëvajtjen e eventit live.
- Integrimi i sinjalit në sistemin Marsis Playout.
- Përgatitja e listës së transmetimit (playlist) për eventet live dhe ato relive (ritransmetim).
- Menaxhimi i grafikave dhe elementeve vizuale përmes sistemit CG (Character Generator), duke përfshirë logot e kanalit, identitetin vizual dhe overlay-t përkatëse.
- Planifikimi dhe ekzekutimi i reklamave sipas rendit të përcaktuar (playlist) gjatë pushimeve dhe ndërprerjeve.
- Ndërprerja dhe rifillimi i transmetimit në përputhje me rrjedhën e ndeshjes (p.sh. fundi i pjesës së parë, pushimi midis pjesëve, etj.).
- Monitorimi i vazhdueshëm i sinjalit dhe i cilësisë së transmetimit përmes encoder-it dhe sistemeve përkatëse.
- Koordinimi me stafin teknik dhe editorial për mbarëvajtjen e transmetimit live.
- Reagimi në kohë reale ndaj problemeve teknike dhe sigurimi i vazhdimësisë së transmetimit.

dh



Kushtet dhe kriteret që: Teknik për Transmetimin e Ndeshjeve të FIFA World Cup 2026 duhet t'i plotësojë:

- Shkollë e mesme.
- Përvojë në operimin e sistemeve Playout (preferohet eksperiencë me Marsis).
- Njohuri në menaxhimin e sinjaleve video/audio dhe proceset e punës (workflows) në broadcast.
- Përvojë me sisteme grafike (CG) dhe insertim reklamash.
- Përvojë në transmetimin e ngjarjeve të mëdha sportive, si Kampionati Botëror ose Kampionati Evropian.
- Aftësi për punë në kushte live dhe nën presion.
- Disponueshmëri gjatë orareve të ndeshjeve.

Forma e angazhimit

- Angazhim me kontratë të përkohshme, për kohëzgjatjen e projektit.
- Raporton drejtpërdrejt të menaxhmenti përgjegjës i Telekomit të Kosovës.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesa për punësim/Aplikacioni (që mund të merret edhe online në www.kosovotelecom.com)
- CV e detajuar
- Letra motivuese
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmitë e kualifikimit (diploma, certifikata, etj.)
- Certifikata e nxjerrë nga gjykata kompetente që vërteton se aplikanti nuk është nën hetime (jo më të vjetër se 6 muaj).

Dokumentacioni i lartcekur duhet të dorëzohet personalisht në zarf të mbyllur në zyrën e arkivit qendror në katin e VI-të, zyra nr.603, ndërtesa kryesore e TK SH.A Dardania p.n.10000 Prishtinë, Republika e Kosovës ose në e-mail adresën hr@kosovotelecom.com

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe joadekuat do të refuzohen.

Për kualifikimin e kandidatëve dhe rezultatet e arritura në këtë proces të përzgjedhjes, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes e-mailit zyrtar hr@kosovotelecom.com brenda afateve të parapara ligjore.